




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	140/15
Nr. i fq. / Br. st	- 12 -
Data: / Datum	25.06.2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -V-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISE,
MBAJTUR MË 28 MAJ 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:17**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi që në pikën në të ndryshme të futet një pikë shtesë e rendit të ditës, kërkesa për ndihmë financiare për ndërtimin e shtëpisë për Istref Veselin nga fshati Smrekonicë në vlerë prej 2.000€, pasi për të njëjtin kanë participuar edhe bashkëfshatarët e tij. Ai kërkoi nga kuvendi që kjo kërkesë të futet në rend dite për shqyrtim pasi që kjo familje ndodhet në gjendje të rëndë sociale dhe atë të banimit, kurse shtëpia që është duke iu ndërtuar i janë përfunduar muret dhe tani ka mbetur që t'i vendoset pullazi. Në fund ai tha se personi i sipërcekur ka parashtruar një kërkesë për ndihmë e adresuar për Kuvendin Komunal të Vushtrrisë dhe për KPF-në, dhe shprehi habinë e tij që asnjëherë dhe në asnjë rast këto kërkesa nuk adresohen tek anëtarët e kuvendit edhe pse të njëjtat duhet t'i shqyrtojnë këto organe.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - njoftoi kuvendin për një kërkesë nga një qytetar Besim Shyti, i cili ka kërkuar që të referojë para kuvendit dhe kërkoi nga kuvendi që konform Rregullores së Punës së Kuvendit që këtij qytetari t'i jepet fjala që të paraqitet para kuvendit.

Besim Shyti - paraqiti shqetësimin e tij para anëtarëve të kuvendit, duke shtuar se drejtori i SHFMU-2 Sahit Parduza ka marrë një vendim për moslejimin e djalit të tij Arlind Shytit që jetë pjesë e ekskursionit. Tutje ai shtoi se një ndalesë e tillë është diskriminim dhe shkelje e të drejtave të fëmijëve. Në fund ai kërkoi nga kuvendi që të deklarohet lidhur me këtë çështje përmes një vendimi qoftë për apo kundër shkuarjes së këtij nxënësi në ekskursion.

Musaj Tërbunja, Drejtor i DA-së - paraqiti sqarime lidhur me çështjen në fjalë, dhe kërkoi nga kuvendi që ta formojë një komision për verifikimin e këtij rasti.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – kërkoi që në pikën në të ndryshme të futet një informatë për gjendjen momentale të fabrikës “Llamkos” në Vushtrri. Tutje në arsyetimin e saj për futjen në rend të ditës të një pike të tillë e bazoi në faktin se përmes mediave është alarmuar për rrezikun e madh që na kanoset nga shpërthimi i bocave të amoniakut, që është pasojë e mungesës së energjisë elektrike dhe nuk mund të mirëmbahen si duhet.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – duke iu referuar një takimi me banorët e fshatit Lumadh, dhe një pjese të lagjeve të fshatit Stanoc i Epërm, të cilët kanë kërkuar nga institucionet komunale me nënshkrimin e afro 750 banorëve të atyre fshatrave për një problem të tyre që ka të bëjë me trasenë e ndërtimit të rrugës Vushtrri-Prishtinë. Tutje ai duke iu referuar gjithnjë këtyre qytetarëve transmetoi se ata ankohen në devijimin e rrugës dhe ndërrimit të kahjes së kësaj rruge. Pastaj sqaroi se këta qytetarë kanë ankesa edhe sa i përket vendkalimeve që janë të precizuara në këtë projekt, sepse siç pretendojnë ata ka ndryshime sa i përket projektit aktual nga ai i mëhershmi. Andaj nga të lartcekurat me qëllim të shmangies së situatave të pakëndshme, siç është bllokimi i rrugës apo edhe forma tjera, kërkoi nga administrata komunale që një kërkesë e tillë mos të injorohet po të merret në shqyrtim dhe të gjendet një zgjidhje. Konform këtyre kërkoi nga kuvendi që një pikë e tillë të futet në rend dite për shqyrtim në pikën në të ndryshme.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, shprehu shqetësimin lidhur me dokumentet apo materialet e mbledhjeve që ofrohen para kuvendit ditën e fundit siç ishte rasti me propozim-vendimin për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, e që siç tha ai kësaj çështjeje është dashur t’i jepet një hapësirë më e madhe që edhe grupet kuvendare tjera të përfaqësuara në kuvend t’i japin propozimet e tyre për njerëzit e merituar për ndarjen e këtyre mirënjohjeve. Në fund ripërsëriti kërkesën për informatë lidhur me bashkëpunimin në mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Vaxjo të Suedisë.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - gjithashtu përkrahu mendimin që kërkesa e fshatit Stanoc i Epërm lidhur me trasenë e rrugës Vushtrri-Prishtinë të futet në rend dite.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi që vendimi lidhur me moslejimin e shkuarjes në ekskursion të nxënësit Arlind Shyti të anulohet dhe arsyetoi se në bazë të legjislacionit në fuqi shkolla fillore është e obligueshme, andaj një vendim i tillë është jologjik dhe i padrejtë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - gjithashtu shprehu mendimin që drejtori i DA-së në bashkëpunim me drejtorin SHFMU-2 të angazhohen në gjetjen e një zgjidhjeje që këtij nxënësi t’i bëhet e mundur të mos ndahet nga shokët dhe shoqet e klasës dhe t’i lejohet pjesëmarrja në ekskursion.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 2016/01 për komuna.
3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve.
4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare nga Fondi për Subvencione dhe Transfere.
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.
6. Shqyrtimi i Informatës për rrjedhat e aplikimit për subvencionimin e fermerëve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
7. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mirënjohjeve për nderë të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë.
 - b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve.
 - c). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave.
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Istref Veselin.
 - d). Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen në fabrikën “Llamkos”.
 - dh). Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Lumadh dhe Stanoc i Epërm lidhur me trasenë e rrugës Vushtri-Prishtinë.
 - e). Shqyrtimi i kërkesës së prindit të Arlind Shytit lidhur me moslejimin e shkuarjes së tij në ekskursion.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se nuk e kontestoj mënyrën e hartimit të këtij procesverbali, por në kuptimin e përmbajtjes ceku se në dy apo tri takime radhazi të kuvendit ka kërkuar që raportet financiare t’u dërgohen anëtarëve të kuvendit. Tutje ceku se në këtë procesverbal këto çështje janë të numëruara taksativisht. Tutje shtoi se ne si kuvend kemi kërkuar transparencë në shpenzimet komunale dhe atë në të gjitha kategoritë ekonomike. Në këtë kontekst ai kërkoi që të konstatohet në procesverbal që anëtarët e kuvendit nuk po marrin përgjigje lidhur me çështjet e sipërapostrofuara që kanë të bëjnë me raportet financiare të komunës. Në fund ai duke akscentuar lidhur me auditorin e brendshëm kërkoi që ai të mobilizohet pasi që ka edhe obligim dhe përgjegjësi që të angazhohet sa më shumë në pasqyrimin real të gjendjes së shpenzimeve buxhetore në komunën tonë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin në fjalë me vërejtjen dhe sugjerimet e paraqitura më lart.

2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 2016/01 për komuna.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shprehur shqetësimin e tij për mosvotimin për futje në rend të ditës të Propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, dhe ceku mosvotimi i kësaj pike të rendit të ditës do të jetë në përgjegjësinë e anëtarëve të kuvendit. Në vazhdim ai parashtrroi të dhëna lidhur me Qarkoren Buxhetore për vitin 2016.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se pasi që ne si kuvend nuk kemi mundësi që të bëjmë ndryshime në këtë qarkore buxhetore lidhur me kufijtë dhe mjetet e planifikuara të buxhetit për vitin 2016 të planifikuara në këtë qarkore, atëherë është mirë që t’i përmbahemi kritereve dhe

afateve. Tutje ai apeloj tek kuvendi e veçanërisht tek Komiteti për Politikë dhe Financa për një mobilizim të përgjithshëm në mënyrë që të kemi një planifikim të qëlluar dhe me afat të buxhetit për vitin 2016. Në vazhdim ai ceku se drejtoritë komunale janë të obliguara që në afat të përcaktuar me këtë qarkore të bëjnë kalkulimin e mjeteve, të cilat iu nevojiten për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Në fund ai tha se KPF-ja së bashku me ekzekutivin komunal duhet të kenë një plan për realizimin e vizitave në lokalitete të ndryshme gjatë fazës së planifikimit të buxhetit për vitin 2016.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se është obligim dhe përgjegjësi e kuvendit që të provojë hapat konkret të planifikimit të buxhetit për vitin vijues. Tutje vlerësoi se Drejtoria për Buxhet dhe Financa me kohë ka përgatitur propozimet dhe ka caktuar hapat që duhet të ndërmerren në kuptimin formal-juridik që në fund të shtatorit ta kemi të aprovuar buxhetin për vitin 2016. Pastaj ai ceku se është kërkesë e tij që të kemi një shqyrtim transparent dhe gjithëpërfshirës nga grupet e caktuara, por edhe nga të gjithë qytetarët në kuadër të një debati të hapur dhe kualitativ lidhur me planifikimin e buxhetit. Në vazhdim ai ceku se duhet të konsultohen qytetarët lidhur me përcaktimin e prioriteteve lidhur me programet dhe projektet konkrete të parashikuara në kuadër të buxhetit. Në këtë kuadër ai vlerësoi se çështja e përcaktimit të prioriteteve sikur po mbetet në përgjegjësinë e individëve të caktuar apo vetëm në përgjegjësinë e administratës komunale. Në këtë relacion ai duke iu referuar përcaktimit të prioriteteve lidhur me orientimin e projekteve ceku se në këtë çështje duhet të merren për bazë kriteret dhe parimet, të cilat janë të përcaktuara edhe me ligj, e që si parim bazë duhet të merret pagesa e taksave dhe tatimeve komunale dhe varësisht nga shkalla e këtyre inkasimeve të orientohen edhe investimet apo projektet.

3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - njoftoi kuvendin se kryetari i komunës ka caktuar për anëtar të këtij komisioni Gani Imerin, drejtor i DSHP-së sipas detyrës zyrtare.

Sabri Ferati, anëtar i kuvendit - propozoi për anëtar të Komisionit të Aksionarëve Mentor Ferizin.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - propozoi për anëtar të këtij komisioni Safet Idrizin.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – në emër të grupit parlamentar të LDK-së propozoi për anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve Agron Përçukun.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - deklaroi se tërhiqet nga propozimi për anëtar të këtij komisioni pasi që njoftoi se është i ngarkuar me detyra dhe obligime tjera.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – propozoi Ilimi Azemin për anëtar të këtij komisioni.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 23 vota për, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Rajonale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë, për Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:

1.1 Ilimi Azemi, anëtar i Kuvendit;

1.2 Mentor Ferizi, anëtar i Kuvendit;

1.3 Gani Imeri, anëtar i Ekzekutivit.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe akteve tjera juridike në fuqi me të cilat është rregulluar kjo çështje.

4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare nga Fondi për Subvencione dhe Transfere.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së e përkrahi propozim-vendimin në fjalë për ndarjen e mjeteve financiare nga Fondi për Subvencione dhe Transfere për Arbër Igrishtën dhe në të njëjtën kohë i uroi sukses në garën ndërkombëtare të matematikanëve.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - transmetoi porosinë nga mësimdhënësit e universitetit të cilët e kanë monitoruar testin e matematikës e të cilët u kanë sugjeruar autoriteteve komunale të Vushtrisë që nxënësit Arbër Igrishta t'i dilet në ndihmë. Në fund ai përkrahu propozimin për ofrimin e ndihmës për nxënësin në fjalë dhe vlerësoi se është nder dhe krenari për ne që kemi nxënës të tillë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – e përkrahu propozim-vendimin në fjalë për ndarjen e mjeteve financiare për nxënësin Arbër Igrishta, dhe njëkohësisht i uroi suksese për një përfaqësim sa më dinjitoz në garën ndërkombëtare të matematikanëve.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se grupi kuvendar i LDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë për ndarjen e këtyre mjeteve financiare për nxënësin Arbër Igrishta dhe i uroi suksese në Garën ndërkombëtare të matematikanëve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim i ndahen mjete financiare Arbër Igrishtës, nxënës i Gjimnazit “Eqrem Çabej”, në shumën prej një mijë e pesëqind euro (1.500), për shkak të pjesëmarrjes së tij në garën Olimpiada Matematike Ndërkombëtare, e cila mbahet në qytetin Chaing Mai të Tajlandës, nga data 04 deri me 16 korrik 2015.

2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të ndahet nga kategoria subvencione dhe transfere, dhe kjo shumë ndahet në emër të Vjollca Igrishtës nëna e të lartcekurit, për shkak se i njëjti është i moshës së mitur.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrisë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket mbrojtjes së pyjeve kjo është vetëm farsë e pushtetit aktual, sepse jo vetëm që nuk po mbrohen pyjet, por ato për çdo ditë e më tepër po shkatërrohen nga prerësit ilegal. Tutje shtoi se në informatën për pyjet nga drejtoria përkatëse kemi vërejtur mospërputhje të shifrave, ku në njërin pikë thuhet se kanë qenë të paraqitura 91 kërkesa për prerje, prej të cilave 62 kanë marrë leje, dhe menjëherë në pikën vijuese thuhet që të gjithë aplikuesit i kemi pajisur me leje për prerje dhe dokumentacion përkatës. Tash shtrohet pyetja se: A janë pajisur të gjithë aplikuesit apo 62 aplikues? Pastaj ceku se në pikën vijuese thuhet se në bashkëpunim me policinë janë bërë kontrole, si dhe konfiskime. Pyetja e radhës është se: A është bërë ndëshkimi i rojeve, të cilët nuk kanë qenë të përgjegjshëm në ruajtjen e pyjeve? Gjithashtu në këtë kuadër ai shtoi si çështje mjaft me interes faktin se përse nuk kanë qenë të mbuluara me roje tri terrene gjatë tërë vitit, por vetëm me periudha? Në fund ai tha se Komuna e Vushtrisë ka nevojë që të bëjë shumë më shumë për Sektorin e pylltarisë veçanërisht duke e rritur buxhetin për këtë sektor. Në fund tha se kërkojmë që urgjentisht të bëhet ripyllëzimi në territorin e komunës sonë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – tha se në informatë thuhet se janë paraqitur 91 kërkesa për prerje të pyjeve 62 nga të cilat kanë marr leje, andaj në këtë kontekst pyeti se çfarë kriteresh merren për bazë kur jepet një leje kur këta persona kërkojnë, kur dihet roli dhe rëndësia e

pyjeve në mbrojtjen e mjedisit tonë. Tutje shtoi se nga informata del konstatimi se procesi i ripyllëzimit ka dështuar, dhe ceku se me këtë proces duhet të merren profesionistët e jo që këto gjëra të bëhen “sa për sy e faqe”, pasi që të kthehen tokat në shkëmbinj. Pastaj ajo vlerësoi se komuna jonë fatmirësisht ka një sipërfaqe solide me pyje prej 13.218 hektarë, por fatkeqësia jonë është se ne shumë pak merremi me menaxhimin e tyre dhe këtë e argumenton më së miri fakti se për gjithë këto sipërfaqe janë angazhuar vetëm 3 roje për ruajtjen e tyre, andaj nëse e shikojmë proporcionin atëherë del në pah fakti se për sipërfaqen pyjore prej 350-1500 hektarë duhet të kujdeset një roje. Në vazhdim ajo vlerësoi se autoritet komunale nuk kanë bërë asgjë në vetëdijesimin e qytetarëve për rolin dhe rëndësinë e pyjeve dhe për mbrojtjen e tyre për faktin se një gjë e tillë është e mundshme dhe shumë imediate. Pastaj ajo duke iu referuar një thënie citoi: “*humbja e pyjeve sot do të thotë thatësi nesër, e uri pasnesër*”, pastaj një thënie e një mendimtari? “*nëse doni ta shkatërrojnë një popull shkatërrojani pyjet*”, andaj fakti që menaxhimi i pyjeve është kaq jo në nivel, menaxhimi i mbeturinave po ashtu dhe ndikimi në mbrojtjen e mjedisit jo i mjaftueshëm të çon në përfundim se drejtoritë janë të stërngarkuara dhe nuk mund të jenë të suksesshme në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve kualitative, e që për këtë çështje është më se e nevojshme formimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit, e cila do të merrej me këtë çështje në mënyrë më të drejtpërdrejt dhe rezultatet nuk do të mungonin dhe përsëriti se këtë propozim e ka pasur edhe në mandatin e kaluar.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - tha se gjendja e pyjeve në përgjithësi në Kosovë, por në veçanti edhe në komunën tonë është mjaft shqetësuese dhe se në këtë kontekst kemi nevojë të pajtërsueshme për të debatuar rreth saj. Tutje shtoi se sipërfaqet pyjore në komunën tonë ditaditës po shkojnë drejt shkatërrimit të ekosistemit dhe dëmtimeve të mëdha ekologjike që në këtë rast sjellin deri tek zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara me pak oksigjen dhe dioksid të karbonit (Co2) të harxhuar, pastaj prishje të klimës, mikroklimës, balonave të ujit, habitateve jetësore të bimëve dhe shtazëve, si dhe zvogëlimin e hapësirave për rekreacione dhe pushime të ndryshme për njeriun dhe ekosistemin në përgjithësi. Pastaj ai apeloj që urgjentisht të ndërmerren masa të rrepta dhe drastike për parandalimin e shkatërrimit të pyjeve. Gjithashtu ai apeloj që të formohen grupe punuese dhe shoqata që si prioritet do të kenë ruajtjen e ambientit dhe mosshkatërrimin e tij, futjen nën kontroll të biznesit të pyjeve, prerjeve ilegale dhe që të merren masa për ripyllëzimin e sipërfaqeve të dëmtuara. Në fund pyeti se sa pika kontrolli gjenden në komunën tonë për verifikimin e gjendjes momentale të prerjes së pyjeve, si dhe pyeti se sa kontrole rutinore janë kryer në bashkëpunim me Agjencinë e Pyjeve dhe me policinë në Komunën e Vushtrrisë sa fletëdenoncime janë adresuar brenda një viti.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se kjo informatë është e hartuar mirë dhe mund të thuhet se gjërat janë përshkruar si duhet, ku shtoi se gjendja në terren sa i përket ruajtjes së pyjeve nuk është e mirë. Tutje ai pyeti se përse vetëm periodikisht drejtoria angazhon rojtarë të pyllit e nuk zgjidhen punëtorë të përhershëm. Në fund ai tha se është mirë që rojat e pyllit të angazhohen edhe ditëve të vikendeve për faktin se në këtë kohë pylli dëmtohet (prehet) më së shumti.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se pyjet dhe gjelbërimi në komunën tonë është duke u shkatërruar në mënyrë masive. Tutje ai e kontestoi informatën në pikën ku thuhet se prej 91 kërkesave për prerje të pyllit 62 prej tyre kanë marrë leje për një prerje të tillë, kurse në pikën vijuese të informatës thuhet se të gjithë aplikuesit e këtyre kërkesave i kemi pajisur me leje, gjë kjo e cila bie në kolizion njëra me tjetrën. Pastaj ceku se në komunën tonë mungon ripyllëzimi, dhe për këtë çështje fajësohet kompania e cila ka qenë përgjegjëse për një gjë të tillë, dhe për këtë pyeti se a janë ndërmarrë masa ndaj kësaj kompanie. Në vazhdim ai duke iu referuar informatës në fjalë ceku se tri terrenet të cilat thuhet se janë të pambuluara me roje pylli, në këtë rast vlerësoi se në informatë duhet të specifikohen ato terrene dhe pse këto terrene janë të pambuluara. Mandej ai duke bërë krahasime analitike ceku se numri i rojeve është mjaft i vogël kur dihet fakti një rojtar duhet të mbulojë terren prej 350-1500 hektarë me pyje, andaj konform kësaj kur ta marrim për bazë totalin e sipërfaqes me pyje prej 13.218 hektarë, atëherë shtrohet

nevoja që komuna jonë duhet të ketë 10 roje të pyjeve. Në fund ai para kuvendit paraqiti një shqetësim të një punëtori që punon si roje e pyllit.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – paraqiti një shqetësim të dy punëtorëve të pylltarisë, Abedin Haradini dhe Ismet Fazliu dhe njoftoi kuvendin se këta punëtorë kanë parashtruar një ankesë me shkrim të cilën e lexoi para anëtarëve të kuvendit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se përpos informatës me shkrim e cila iu është ofruar anëtarëve të kuvendit, është dashur që edhe drejtori i bujqësisë të referojë para kuvendit dhe t'u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve të anëtarëve të kuvendit. Në fund ai shprehu shqetësimin e tij lidhur me mosprezencën e drejtorëve të drejtorive në mbledhjet e kuvendit.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - fillimisht arsyetoi mungesën e kryetarit të komunës dhe drejtoreshës së bujqësisë për mungesën e tyre në mbledhjen e kuvendit. Tutje ai duke iu referuar mbrojtjes së pyjeve tha se gjendja është mjaft e rëndë për shkak të sipërfaqes së madhe me pyje dhe numrit të vogël të rojave të pyllit. Pastaj ai njoftoi kuvendin se deri vonë kanë qenë roje të pyllit, ku njëri prej tyre për një kohë të gjatë ka qenë në pushim mjekësor dhe aktualisht për shkak të moshës është pensionuar. Në këtë kontekst ai arsyetoi se me qëllim të mbulimit të këtij vakumi komuna ka marrë punëtorë me kontratë mbi veprën konform ligjit. Në fund ai njoftoi për një rast të ballafaqimit të rojave të pyllit dhe policisë me keqbërësit (prerësit ilegal të pyjeve), gjithashtu ai premtoi se në një të ardhme të afërt drejtoria do të hartojë një rregullore lidhur me menaxhimin e pyjeve dhe kështu do të bëjmë përpjekje që kjo çështje të rregullohet.

6. Shqyrtimi i Informatës për rrjedhat e aplikimit për subvencionimin e fermerëve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se ndarja e buxhetit për Sektorin e bujqësisë nuk është në proporcion me sipërfaqen e punueshme të territorit të Vushtrrisë, kur dihet se Vushtrria ka sipërfaqe shumë të madhe të tokës pjellore e cila dita-ditës po degradohet dhe po i ndërrohet destinacioni, falë mungesës së politikave për mbrojtjen e sipërfaqes së punueshme të tokës (ndërtimet pa leje). Tutje shtoi se buxheti i ndarë për Sektorin e bujqësisë është nënçmues për prodhuesit duke e ditur që bujqësia është ndër sektorët kryesor që mund të gjenerojë vende të reja pune. Pastaj vlerësoi që rritja e buxhetit për Sektorin e bujqësisë kontribuon qoftë në zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese në teknologjinë ushqimore, ku lënda e parë prodhohet në vend e cila pastaj edhe do përpunohet deri në prodhim final. Mandej ai ceku se e ndan mendimin që nuk është efikase kur këto ndihma, subvencione e grante iu jepen “fermerëve”, kurse në anën tjetër atyre iu mungojnë këshillat nga ekspertët e lëmenjve përkatës. Në këtë mënyrë po demotivohen edhe të rinjtë që të studiojnë lëmenjtë bujqësor, të pashpresë se një ditë do të jenë të punësuar si ekspertë bujqësor. Ndër të tjera, ai bëri të ditur se i intereson fakti se pse Komuna e Vushtrrisë nuk ka ndërmarrë asnjë hap për marrjen e mostrave të tokave në pjesë të ndryshme të komunës dhe dërgimin e tyre për analiza pedologjike, ku do të përcaktohej kualiteti dhe përbërja pedologjike e tokës, që pastaj përmes këshillave të ekspertëve bujqësorë do të përcaktohej se cilat kultura bujqësore, pemishte apo vreshta, blegtori apo bletari do të zhvilloheshin më tepër në lokacionet përkatëse. Në këtë mënyrë edhe fermerët do të orientoheshin më lehtë. Këto analiza pedologjike të tokave gjithashtu do të përcaktonin se çfarë përbërje kanë ato toka dhe për cilat elemente ushqyese kanë nevojë më tepër. Fermerët tanë shpenzojnë shuma të mëdha parash në plehra pa e ditur se ndoshta ajo tokë është e ngopur me ato elemente ushqyese por i mungojnë elementet të tjera. Për këtë arsye edhe rendimentet për shumicën e kulturave bujqësore janë të ulëta krahasuar me vendet e rajonit. Kjo do t'i kushtonte komunës rreth 15 – 20 mijë euro, por në anën tjetër do t'i kursente prodhuesit qindra mijëra euro, sepse ata do t'i blenin plehtrat me ato elemente ushqyese që i mungojnë tokës.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - kërkoi nga Drejtoria e Bujqësisë informatë me shkrim për listat e përfituesve, ku do të cekej emri, mbiemri dhe vendbanimi i përfituesit të subvencioneve, si dhe të specifikohet se sa kanë qenë subvencionet e komunës dhe ato të ministrisë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - kërkoi nga anëtarët e kuvendit që kuvendi të shkojë në një pauzë prej 10 minutave për konsultim me shefat e grupeve kuvendare lidhur me Propozim-vendimin për rishikimin e buxhetit.

Lidhur me këtë çështje, Kuvendi pas votimit me “19 vota për” “ tjerat abstenim” vendosi që mbledhja e Kuvendit të ndërpritet me një pauzë prej 10 minutave për konsultim me shefat e grupeve kuvendare lidhur me Propozim-vendimin për rishikimin e buxhetit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - njoftoi se në konsultim me zyrtarët e Ministrisë së Pushtetit Lokal, por edhe me shefat e grupeve kuvendare, dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, ku thuhet se për një pikë të rendit të ditës e cila është futur në rend të ditës për shqyrtim e njëjta nuk mund të hiqet nga rendi i ditës.

7. Të ndryshme.

7.a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mirënjohjeve për nderë të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Vushtrisë.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi që Xhafer Istrefit (post mortum) t'i ndahet çmimi “Nderi i qytetit”. Tutje ai një propozim të tillë e arsyetoi: Xhafer Istrefi ishte veprimtar i devotshëm i çështjes kombëtare, njëherit themelues dhe kryetar i SHFD-së së UÇK-së dega në Vushtrri dhe është baba i dëshmorit Shemsi Istrefit.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së – paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se në bazë të Rregullores për Dekoratat është kriter që për shënimin e një date të rëndësishme nuk ndahen më shumë se 10 dekorata.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se ajo se çka tha drejtoresha e kulturës lidhur me propozimet që dalin konform rregullores është një fakt notor, dhe shtoi se ajo çka është jo transparente është fakti se ne si grupe kuvendare nuk jemi njoftuar për afatin e caktuar që edhe ne t'i parashtrijmë propozimet tona apo kjo çështje ka mbetur ekskluzivisht në kompetencën e komisionit që është formuar nga ekzekutivi komunal për këtë çështje. Andaj nga të lartcekurat vlerësoi se puna rreth ndarjes së këtyre mirënjohjeve duhet të jetë transparente, gjithëpërfshirëse dhe meritore. Në fund ai propozoi Rifat Dërgutin që t'i ndahet një mirënjohje për kontributin e tij si zeztar i vjetër Vushtrrias.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – propozoi Mensur Kasumin zëvendëskomandant i UÇK-së i ZOSH, për kontributin e tij luftarak që t'i ndahet një mirënjohje.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se lidhur me çështjen e këtyre propozimeve nuk janë konsultuar aspak grupet kuvendare të përfaqësuara në kuvend, dhe ceku se me qëllim të respektimit të kritereve propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime ” vendosi me sa vijon:

Hiqet nga rendi i ditës Propozim-Vendimi për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Vushtrisë, pas konsultimeve dhe pajtueshmërisë së të gjitha grupeve kuvendare të përfaqësuara në Kuvend.

7.b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – propozoi Shkelzen Fekën për anëtar të Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Habib Mustafën për anëtar të Komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave lidhur me emërtimin e rrugëve.

Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit - nga komuniteti serb propozon Delibor Disicin për anëtar të këtij komisioni.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - propozoi që ky komision të zgjerohet edhe me një anëtar nga komuniteti turk, dhe atë Ergyn Sungurin.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së - paraqiti sqarime të nevojshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke dhënë këshilla lidhur me anën ligjore të kësaj çështjeje sa i përket përbërjes së këtij komisioni.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Myrvete Hetemin për anëtare të këtij komisioni.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

1.1. Ilirjana Azemi, Drejtorja për Urbanizëm;

1.2. Islam Latifi, Drejtorja për Shërbime Publike;

1.3. Isa Latifi, Drejtorja për Urbanizëm,

1.4. Habib Mustafa, anëtar i kuvendit PDK;

1.5. Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit LDK;

1.6. Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit VV;

1.7. Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit KDTP;

1.8. Gëzim Zuçaku, përfaqësues i SHFD-së të UÇK-së, dega në Vushtri;

1.9. Delibor Disic, komuniteti serb.

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe ankesat e parashtruara nga qytetarët, lidhur me emërtimet e vendosura të rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

7.c). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozon Syzana Sylën për anëtare të këtij komisioni.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Xhevahire Asllanin, për anëtare të këtij komisioni.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohen propozimet për anëtar të Komisionit Komunal për Bursa konform Rregullores Nr.86/15 të datës 30.04.2015 për Ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimet për Nxënësit e Komunës së Vushtrrisë, dhe ato janë:

Xhevahire Selamani, anëtare e kuvendit, PDK dhe Syzana Sylja, anëtare e kuvendit LDK.

ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Istref Veselin.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se, para çdo vendimi që duhet të aprovohet nga ana e kuvendit duhet të shikohet lista interne që është e miratuar nga kuvendi me qëllim që të bëhet harmonizimi i plotë me listën e shpërndarjes së subvencioneve e cila është aprovuar në rastin e planifikimit të buxhetit, dhe njoftoi se mjete financiare ka por në rastin e këtij vendimi duhet të anulohet ndonjë pozicion ekonomik.

Ilimi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se i ka shikuar pozicionet ekonomike të inkorporuara në buxhetin komunal dhe se ka vërejtur se në Zyrën e kryetarit ka mjete të lira, kështu që propozoi që një propozim i tillë të aprovohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej dy mijë euro (2.000€) nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve (Zyra e kryetarit), për Istref Veselin nga fshati Smrekonicë, Komuna e Vushtrrisë.
2. Shuma e cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë së tij.

7.d). Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen në fabrikën “Llamkos”.

Nezir Klinaku, drejtor i DMSH-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se fabrika “Llamkos” gjendet në procedurën e falimentimit dhe se për këtë çështje është caktuar edhe administratori falimentues, andaj komuna ka marrë të gjitha masat e duhura lidhur me sigurinë e këtij objekti.

7.dh). Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Lumadh dhe Stanoc i Epërm lidhur me trasenë e rrugës Vushtri-Prishtinë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se të inJOROSH apo të heshtësh rastin e kërkesës së 750 qytetarëve lidhur me shqetësimin e tyre ndoshta është një lloj papërgjegjësie, qoftë në nivelin komunal apo atë qendror andaj konsideron se si kuvendi duhet të kërkojmë sot me një qëndrim nga administrata komunale, por edhe nga anëtarët e kuvendit të rajonit të këtyre fshatrave, por edhe nga ministria përkatëse që kjo çështje të trajtohet në mënyrën më serioze të mundshme dhe t’u jepet përgjigje atyre qytetarëve, qoftë tek drejtimi i trasesë së rrugës Vushtri-Prishtinë apo tek format tjera tek pengesat tjera në kryerjen e punëve me qëllim që të kemi një tablo të përgjithshme të informatës me shkrim lidhur me këtë çështje. Në fund ai tha se duhet të angazhohemi të gjithë në gjetjen e një zgjidhjeje vërtet adekuate dhe t’i shmangemi veprimeve radikale nga ana e këtyre qytetarëve.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - tha se kërkesat e parashtruara nga ana e këtyre qytetarëve janë plotësisht legjitime dhe ceku se për këtë çështje duhet të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për të gjithë. Tutje ai shtoi se vendndaljes (stacionit) në fshatin Stanoc nuk duhet t’i ndërrohet vendi, por duhet të mbetet aty ku ka qenë më parë. Në vazhdim ai kërkoi nga

kuvendi që të formohet një komision prej 3 anëtarësh ku i njëjti do të kontaktonte me ministrinë përkatëse dhe të bëhet kjo kërkesë dhe të legjitimohet.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - tha se si komunë jemi të njoftuar me këtë problem të qytetarëve të këtyre fshatrave dhe ceku se si komunë nuk e kemi heshtur këtë problem dhe se dihet mirëfilli se ky projekt është i ministrisë e jo i komunës. Tutje ai shtoi se kryetari i komunës ka kontaktuar me zyrtarët e ministrisë përkatëse, dhe i ka njoftuar me shqetësimin e këtyre qytetarëve për faktin se këta qytetarë kanë shprehur dyshimin se është bërë ndërrimi i projektit nga ana e dy zyrtarëve të ministrisë, kurse ata janë zotuar se nuk është ndërruar ky projekt. Pastaj njoftoi se ky projekt është aprovuar në ministri dhe se komuna nuk ka përgjegjësi lidhur me këtë çështje.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se një kërkesë e tillë është e ligjshme dhe si e tillë është shqyrtuar nga ana e administratës komunale dhe është dhënë përgjigja. Tutje ai propozoi që për seancën e ardhshme të përgatitet materiali dhe kjo pikë e rendit të ditës të futet për shqyrtim. Në fund ai tha se duhet të merren informatat nga ana e ministrisë se përse ka ndryshuar një projekt i tillë dhe nëse po cilat janë arsyet.

7.e). Shqyrtimi i kërkesës së prindit të Arlind Shytit lidhur me moslejimin e shkuarjes së tij në ekskursion.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së - tha se e kuptoj shqetësimin e prindit, por nuk e kuptoj insistimin e disa prej anëtarëve të kuvendit, që një kërkesë e cila ka ardhur sot në mëngjes dhe absolutisht pa u konsultuar me shkollën pa u marrë informatat e nevojshme dhe pa e ditur të vërtetën ta përkrahin një kërkesë të tillë, nuk jemi në dijeni se cili është qëllimi i krejt kësaj. Në fund ai tha se nëse kuvendi ka gatishmëri, atëherë edhe ai është i gatshëm që të formojë një komision për konstatimin e gjendjes faktike dhe të vërtetës lidhur me këtë rast.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se kuvendi komunal i ka aprovuar rregulloret komunale që rregullojnë fushën e arsimit në komunën tonë ku edhe janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet e nxënësve, andaj rasti në fjalë është rast tipik në kompetencat e drejtorisë, dhe se ne si kuvend nuk kemi nevojë që të merremi me këtë çështje.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet fuqishëm mendimin e drejtorit të DA-së, duke mos u lëshuar në rastin konkret, por duke aluduar gjithnjë se kjo çështje bënë pjesë në domenin e kompetencave të Drejtorisë së Arsimit, andaj për një çështje të tillë kuvendi nuk ka arsye që të merret me kompetencat e të tjerëve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit vendosi me sa vijon:

Me “27 vota kundër”, “tjerat abstenim” nuk formohet komisioni për nxënësin e shkollës fillore Arlind Shyti.

7.ë). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – paraqiti një shqetësim të anëtarëve të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” në Vushtri pasi që ky ansambël është institucion publik dhe i themeluar me vendim të këtij kuvendi më datën 26.02.2009, duke u bazuar në ligj. Nga këto shprehu keqardhjen e grupit kuvendar të LDK-së lidhur me mospërkrahjen e këtij ansambli nga ana e organeve komunale. Tutje ajo shtoi se tani ky ansambël nuk është duke u ruajtur për faktin se anëtarët e këtij trupi kanë filluar të sistemohen nëpër vende pune nëpër komunë e gjetiu, konkretisht njëri nga udhëheqësit e orkestrës folklorike është sistemuar në vendin e punës në ofiqari dhe sipas tyre pritët edhe tjerët të kenë fatin e njëjtë. Në fund tha se grupi kuvendar i LDK-së kërkon që ky ansambël të ruhet dhe të mos shuhet.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – duke iu referuar një inserti televiziv lidhur me një lagje në fshatin Studime e Poshtme që ka të bëjë me vërshimet nga ujërat e zeza, meqë tani pasi edhe koha do të nxehet kjo me siguri do të ketë efekte negative. Në lidhje me këtë problematikë ai kërkoi nga autoritetet komunale që në suaza të kompetencave të tyre të dalin dhe të propozojnë masa konkrete për zgjidhjen e atij problemi në qoftë se vërtet tangon në kompetencat e komunës.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – pyeti se kur do të ndërmerren masa për rregullimin e rrugëve në fshatin Bivolak dhe Stroc, pastaj kërkoi që të ndërmerren masa dhe të hiqen mbeturinat në oborrin e xhamisë në fshatin Stroc, ku dhe shprehu shqetësimin e tij lidhur me anashkalimin e problemeve të këtyre lokaliteteve.


Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - paraqiti një shqetësim të banorëve të fshatit Ashlan lidhur me anashkalimin e problemeve të tyre, kurse në vazhdim ajo lexoi para anëtarëve të kuvendit një ankesë të këtyre banorëve.

Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit - ngriti një shqetësim lidhur me mirëmbajtjen e varrezave të vjetra të qytetit, andaj kërkoi nga DSHP-ja që të merr masa për rregullimin e tyre.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - para anëtarëve të kuvendit paraqiti shqetësimin e tij lidhur me mirëmbajtjen e lumit “Tërstena”. Ai tha se në rregullimin e këtij lumi janë bërë investime të mëdha, dhe tani ky lum nuk është duke u mirëmbajt si duhet dhe gjendet në një gjendje jo të mirë. Në fund ai tha se është mirë që të shikohet mundësia që përmes ndonjë projekti të bëhet mbushja me ujë e këtij lumi nga lumi “Silnica” gjatë stinës së verës.


Mbledhja përfundoi në orën 12:23.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit

